



KOMPANIA REGJIONALE E UJITJES  
REGIONAL IRRIGATION COMPANY, J.S.C  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA NAVODNJAVANJE D.D  
"Radoniqi-Dukagjini" Sh.A.  
Rr. UÇK-së p.n Gjakovë, Kosovë  
Tel. 0390/320-054, Tel. Fax 0390/320-536



Me qëllim të implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Ligjit për tatim në të ardhura të korporatave (Ligji nr 03/L-162, Ligjit për shoqërit tregtare (Ligji nr 02/L-123), Ligjit për ndermarrjet publike (Ligji nr 03/L-087), Ligjit për menaxhimin e financave publike (Ligji nr 03/L-048), KRU "Radoniqi-Dukagjini" Sh.a aprovon këtë:

### **Rregullore 01/2018 për provizionimin e llogarive të arkëtueshme**

Departamenti financiar në kuadër të KRU "Radoniqi-Dukagjini" Sh.a është përgjegjës për implementimin e Standardeve Nderkombetare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Nderkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) si dhe të gjitha procedurave dhe politikave kontabël të aprovuara nga kompanija.

Përmes kësaj Rregullore, Kompanija do të ketë një politikë të provizionimit (shlyerjes) në lidhje me kalkulimin e vjetërsisë të llogarive të arkëtueshme dhe një kontrollë më të mirë ndaj kërkesave. Kompanija do të bëjë analiza të rregullta të vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme. Kjo do të ndihmojë menaxhmentit që të përmirësojë arkëtimet dhe barazimet me klientet dhe të bëjë vlersime të sakta për provizione të borgjeve të kqija.

#### **Neni 1**

Rexhistrimet akruale bëhen për të pasur mundësi në parashikimin e të hyrave nga shitjet si dhe lejimet që ju takojnë shitjeve tanimë të konsumuara që nga data e raporteve financiare.

#### **Neni 2**

Harmonizimi i duhur mund të arrihet vetëm nëse shpenzimi për borgjet e kqija është i regjistruar në perioden e njejtë fiskale me të hyrat ndaj të cilave kanë lidhshmëri. Nëse ky shpenzim mund të njihet me saktësi atëherë do të bëhet provizionimi. Duke pasur parasysh klientët e Kompanisë "Radoniqi-Dukagjini" është e mundur të kalkulohet vjetërsia korrekte e llogarive të arkëtueshme.

#### **Neni 3**

Lejimet janë shembuj të konceptit të maturisë dhe janë një vlerësim i përqindjes së borxheve të cilat priten të mos ripaguhen, ku llogaritja e tyre bëhet sipas dy formave

1. Specifike, dhe
2. Lejim i përgjithshëm

#### Neni 4

Lejimi specifik është formë e tillë, ku borxhet trajtohen në mënyrë specifike dhe analitike për secilin konsumator veç e veç.

Regjistrimi ne kontabilitet bëhet

debi: shpenzimin i borxhit të keq-lejimet (PA),

kredi: lejimet për llogarit e arkëtueshme (BGJ)

#### Neni 5

Lejimi i përgjithshëm është formë e tillë që përcaktohet si përqindje e lejimit të bazuara në eksperiencat të mëparshme për borxhet e pa arkëtueshme

- Llogarite e arketueshme me te vjetera se 1 vite provizionohen 100%
- Llogarite e arketueshme me te vjetera se 9 muaj provizionohen 60%
- Llogarite e arketueshme me te vjetera se 6 muaj provizionohen 30%
- Llogarite e arketueshme me te vjetera se 3 muaj provizionohen 10%

Regjistrimi në kontabilitet bëhet :

debi: shpenzimin e borxhit keq (PA)

Kredi: lejimet për llogarit e arkëtueshme (BGJ)

Të arkëtueshmet tregtare në bilancin e gjendjes tregohen neto nga lejimet për të arkëtueshmet.

#### Neni 6

Lejimi për te arketueshmet mbulon borxhet e pa-arketueshme në të ardhmen, si një masë paraprake e marrë me maturi nga biznesi.

- Kur llogaritet për herë të parë një lejim , shuma e lejimit fillestar ngarkohet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave për periudhen në të cilën krijohet lejimi.
- Kur lejimet tashmë ekzistojnë, por janë rritur, shuma e rritjes së lejimit ngarkohet si shpenzim në PASH per periudhen në të cilën po ndahet lejimi i rritur.
- Kur lejimet zvogëlohen, shuma e zvogëlimit të lejimit kreditohet përsëri në PASH për periudhen në të cilën po ndahet lejimi i zvogëluar.

#### Neni 7

Llogaritë e arkëtueshme dhe pagesat do të rishikohen në fundë të qdo viti financiar për të siguruar se borgjet e dyshimta janë kontabilizuar në mënyrë adekuate.

#### Neni 8

Llogaritja e lejimeve për llogarit e arkëtueshme bëhet çdo fund vit. Forma e llogaritjes sikur të gjitha dokumentat tjera ruhen në librin kryesorë të Kompanisë

#### Neni 9

Kjo rregullore mund të ndryshohet ose plotësohet varësisht nga ndryshimet që mund të ndodhin nga standardet e Kontabilitetit në këtë fushë

## Neni 10

Një borxh i keq konsiderohet shpenzim nëse i plotëson kushtet vijuese:

-pagesa nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht dhe është shpallur si i pambledhshëm duke inicuar procedurat në organet gjyqësore;

- borxhit i kanë kaluar së paku gjashtë muaj nga afati i obligimit për pagesë;

- shuma që korrespondon me borxhin më herët është përfshirë në evidenca kontabël si e ardhur;

- nuk ka kontest mbi vlefshmërinë juridike të borxhit;

- ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të vjelë borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit sikurse janë:

- tatimpaguesi ka balancuar çdo borxh të pakontestueshëm kundrejt borxhit të keq;

- korrespondenca dhe kontaktet në përpjekje për të vjelë borxhin.

## Neni 11

Zbritjet e borxhit të keq janë të kufizuara në pjesën e pambuluar të borxhit. Çdo borxh i keq i zbritur si një shpenzim që pastaj është mbledhë, do të përfshihet në të ardhurat e tatimpaguesit në periudhën e mbledhjes.

## Neni 12

Kjo rregullore hynë në fuqi nga dita e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve të Kompanisë.

Gjakovë  
Datë: 28.09.2018

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve  
Pal Gjuraj

\_\_\_\_\_

